

PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

MASTER SHKENCOR NË “FIZIOTERAPI KLINIKE DHE REHABILITIM”

Programi i studimit të ciklit të dytë **Master Shkencor në “Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim”**, i ofruar nga **Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës**, synon formimin e specialistëve të avancuar me njohuri të thelluara shkencore dhe kompetenca klinike në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit.

Ky program ofrohet për herë të parë në vitin akademik 2026–2027, mbështetur në Urdhrin nr. 327, datë 03.07.2026, të Ministrit të Arsimit.

Programi është hartuar për t’ju përgjigjur kërkesave bashkëkohore të sistemit shëndetësor, spitaleve, qendrave të rehabilitimit dhe klinikave të specializuara për profesionistë të aftë në vlerësimin, diagnostikimin funksional dhe trajtimin e rasteve komplekse klinike mbështetur në praktikat e bazuara në evidencë shkencore.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PROGRAMIN

- **Programi i studimit:** Master Shkencor në “Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim”
- **Cikli i studimit:** Cikli i dytë i Studimeve të Larta
- **Kohëzgjatja:** 2 vite akademike / 4 semestra
- **Gjuha e Mësimdhënies:** Shqip
- **Kredite:** 120 ECTS
- **Forma e studimit:** Me kohë të plotë
- **Emërtimi i diplomës:** “Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim”
- **Departamenti përgjegjës:** Departamenti i Rehabilitimit

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE FORMIMI PROFESIONAL

Masteri Shkencor në “Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim” ka si objektiva kryesore:

1. **Aftësimin Klinik të Avancuar:** Përgatitjen e specialistëve me njohuri të thelluara në vlerësimin dhe trajtimin e patologjive osteomuskulare, neurologjike, ortopedike, kirurgjikale, pediatrike dhe geriatrike.
2. **Vendimmarrjen e Bazuar në Evidencë:** Zhvillimin e aftësive kritike për zbatimin e metodologjive kërkimore dhe gjetjeve më të fundit shkencore në praktikën klinike ditore.
3. **Integrimin e Teknologjive Bashkëkohore:** Integrimin e mjeteve dixhitale, metodave inovative dhe telerehabilitimit për përshtatjen me standardet internacionale të mjekësisë dixhitale.
4. **Qasjen Ndërdisciplinore:** Krijimin e kompetencave për bashkëpunim efektiv me ekipe multidisciplinare mjekësore dhe shëndetësore.

STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR

Plani mësimor organizohet me një shpërndarje graduale modularesh teorike, klinike dhe kërkimore:

VITI I PARË

Semestri I

- Metodologji e Kërkimit Shkencor (*Shkrim Akademik; Metodologji Kërkimi*)
- Shkencat e Komunikimit (*Komunikim Profesional; Bioetikë dhe Legjislacion Mjekësor; Psikologji e Shëndetit*)
- Epidemiologji dhe Mjekësi Preventive (*Epidemiologji; Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor*)
- Mjekësi Fizike dhe Rehabilituese (*Metodologjia e Vlerësimit në Fizioterapi; Teknikat dhe Metodat e Trajtimin në Fizioterapi*)

Semestri II

- Mjekësi Fizike dhe Rehabilituese (*Vijim: Metodologji Vlerësimi & Teknika Trajtimi*)
- Rehabilitim në Patologjitë Osteomuskulare (*Fizioterapi Klinike në Ortopedi e Traumatologji; Reumatologji; Diagnostikë Imazherike; Mjekësi Sportive*)
- Rehabilitim në Sëmundjet e Sistemit Nervor (*Fizioterapi Klinike në Neurologji, Neurokirurgji dhe Psikiatri*)
- Rehabilitim në Pediatri (*Fizioterapi Klinike në Pediatri të Përgjithshme dhe Neuropsikiatri Infantile*)

VITI I DYTË

Semestri I

- Rehabilitim në Patologjitë Kirurgjikale (*Fizioterapi Perioperative, Terapi Intensive, Onkologji & Kujdes Paliativ, Urologji dhe Obstetrikë-Gjinekologji*)
- Rehabilitim në Sëmundjet e Brendshme (*Fizioterapi në Sëmundje të Brendshme dhe Geriatri*)
- Rehabilitim Ndërdisiplinor (*Nutricion Klinik; Telerehabilitim*)

Semestri II

- Praktikë Profesionale: *Zbatim i njohurive teorike dhe zhvillim i kompetencave praktike në mjedise spitalore e klinike të partnerizuara.*
- Mikrotezë / Diplomë: *Zhvillimi dhe mbrojtja e një punimi kërkimor individual shkencor*

STAFI AKADEMIK

Programi mbështetet nga një trupë pedagoge me ekspertizë të lartë akademike dhe klinike në fushat e fizioterapisë, mjekësisë fizike, ortopedisë, neurologjisë, kirurgjisë, pediatriisë, geriatriisë, imazherisë diagnostike dhe kërkimit shkencor.

Gjithashtu, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit është i angazhuar në projekte dhe nisma ndërkombëtare arsimore, me fokus inovacionin dhe zhvillimin e kapaciteteve në fizioterapi.

PERSPEKTIVA E KARRIERËS DHE STUDIMET E MËTEJSHME

Të diplomuarit në këtë program pajisen me kompetencat e nevojshme për t'u punësuar si fizioterapistë të specializuar në:

- Spitale publike dhe private, qendra spitalore dhe klinika rehabilituese;
- Qendra të specializuara të mjekësisë sportive dhe klube profesioniste;
- Institucione kërkimore dhe akademike;
- Sektorin privat të kujdesit shëndetësor.

Me marrjen e diplomës Master Shkencor, të diplomuarit përmbushin gjithashtu kriteret akademike për vijimin e studimeve të ciklit të tretë (**Doktoraturë**).

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT

Pranimet në programin **Master Shkencor në “Fizioterapi Klinike dhe Rehabilitim”** kryhen sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të përcaktuara nga Universiteti i Sporteve të Tiranës, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë.

Kandidatët e interesuar ftohen të ndjekin njoftimet zyrtare në uebsajtin e Universitetit për kriteret e pranimit, dokumentacionin e kërkuar dhe kalendarin e aplikimeve.

KRITERET E PRANIMIT			
Numri minimal i studentëve	12	Numri maksimal i studentëve	45

Titujt e studimit që duhen patur për pranim	▪ Diplomë Bachelor në Shkenca Rehabilitimi, Fizioterapi, Fusha e veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit apo diploma të ngjashme me to. ▪ Diplomë në mjekësi të përgjithshme ▪ Diplomë të universiteteve të tjera brenda ose jashtë vendit të njëvlefshme me diplomat e sipërpërmëndura
Kriter tjetër	• Kriteret e çdo viti të përcaktuara gjatë planifikimit të kuotave të vitit pasardhës